



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1836/12 prot.

Datë 24.09.2025

V E N D I M
Nr. 1317/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.09.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Ankimues: BOE “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK me NIPT K47103804L dhe K94016202U dhe adresë: Elbasan, Gramsh, Sporti

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë me adresë: Rruga “5 Maji” , Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03-02-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

II.2. Në datën 05-03-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 24.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEEN shpk	107,921,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk”	107,979,600 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “KUPA” SHPK	119,948,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “SHPRESA-AL” shpk	120,915,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k	144,295,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “BAMI HOLDING” sh. p.k	148,128,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “DAJTI PARK 2007 ” shpk	160,640,000 lekë pa tvsh	skualifikuar

BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin si vijon:

• OE VIANTE Konstruksion shpk me Nr, NUIS K47103804L ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e subjektit "M U R A T I" shpk me Nr NUIS J66702413V të cilët sipas detyrimeve të përcaktuara nga ligji kanë paraqitur Formular të veçantë të Vetëdeklarimit i cili duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Mbështetur në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.(Kriteret detyruese për skualifikim). Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. - OE "M U R A T I" shpk me Nr NUIS J66702413V ka paraqitur 3 Formular të veçantë të Vetëdeklarimit, por nuk ka paraqitur ne autoritet sipas kërkesës se KVOsë dokumentacion provues ne përmbushje me vetdeklarimin e paraqitur ne Formularin e ngarkuar ne SPE,

konkretisht për pikat si me poshtë vijon: • Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. • Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. • Operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; • Operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; • Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. • Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. • Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.”

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 27.06.2025, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak.

II.5. Në datën 09.07.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5541 dhe me nr.1836 prot., datë 10.07.2025 e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1836/ 1 prot., datë 10.07.2025.

II.7. Në datë 14.07.2025 BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shërbimit postar ankesën për procedurën e mësipërme të prokurimit protokolluar me nr. 1836/2 prot., datë 14.07.2025.

II.8. Me shkresën me nr. 4441/1 prot., datë 16.07.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1836/3 prot., datë 17.07.2025 Agjencia e Prokurimit Publik ka dërguar për kompetencë ankesën e dorëzuar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën me nr. 425/30 prot., datë 11.07.2025 me lëndë “Vënie në dijeni”, protokolluar me tonën me nr. 1863/4 prot., datë 17.07.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për kërkesën drejtuar BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK për korrigjimin e të metave të ankesës me përmbajtje si vijon: *“...në zbatim të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 94 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” autoriteti konstatoi se ankimuesi duhet ti bashkëlidhë ankimit që ka paraqitur në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të prokurimit Publik. Në datë 11.07.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor i kërkoi ankimuesit korigjimin e ankesës brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati ajo konsiderohet si e paparaqitur.*

II.10. Me shkresën me nr. 425/32 prot., datë 14.07.2025 me lëndë “Vendim Komisioni i shqyrtimit të Ankesave”, protokolluar me tonën me nr. 1836/5 prot., datë 17.07.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.11. Me shkresën me nr. 1836/6 prot., datë 22.08.2025 me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni ka njoftuar BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK si vijon: *“Nga shqyrtimi i ankesës rezulton se, objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana juaj. Gjithashtu pretendoni se nuk jeni njoftuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) lidhur me publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraparak nga autoriteti kontraktor. Me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe neneve 23, 24 dhe 26 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK (ku njëri prej tyre të jetë një person i cili disponon të dhënat për tu futur në llogarinë e tij në Sistemin e Prokurimit Elektronik).Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e martë, datë 26.08.2025 ora 12:00.”*

II.12. Me shkresën me datë 25.08.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1836/7 prot., datë 27.08.2025 drejtuar autoritetit kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: *“[...] duke marrë shkas nga faktet dhe nga vlerësimi i autoritetit kontraktor dhe bindjes tonë, kemi ankimuar (brenda afateve ligjore) me datë 09.07.2025 dhe njëkohësisht kemi kryer pagesën konform procedurës ligjore. Ankmimi jonë është pranuar nga oragani kompetent dhe është publikuar menjëherë në sistemin online të pasqyrave të ankimeve”*.

II.13. Me shkresën me nr. 1836/8 prot., datë 26.08.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar autoritetit kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë dhe për dijeni BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacionin si vijon: *“Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga institucioni juaj, të dorëzoni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kërkojmë nga ana juaj të paraqisni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e mësipërm, brenda ditës së nesërme nga marrja dijeni e kësaj shkrese”*.

II.14. Me shkresën me nr. 3999/1 prot., datë 29.08.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr. 1836/9 prot., datë 17.09.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë ka dorëzuar pranë KPP-së dokumentacionin e njehsuar me origjinalin të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.

II.14. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë dorëzuar argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimes, ku një prej të cilave është respektimi i afateve të ankimit.

III.1.1. Në nenin 4, pika 41, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Sistem i prokurimit elektronik” është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik”*

III.1.2. Në nenin 97, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: *“1. Menjëherë, por jo më vonë se 7 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.. 2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”*

III.1.3. Në datën 22.08.2025, me shkresën me nr. 1836/6 prot., me objekt: *“Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, drejtuar shoqërisë “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 26.08.2025, ora 12:00, në mjediset e institucionit të KPP-së, me përfaqësues të shoqërisë ankimes, i cili disponon të dhënat për t’u futur në llogarinë e subjektit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me qellim që të bëhet e mundur hapja e llogarisë së përdoruesit për të vërtetuar nëse BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK ka marrë dijeni për publikimin e Njoftimit të Fituesit.

III.1.4. Në datën 26.08.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Rezulton, se autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit në datë 27.06.2025. Sa i përket BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK pas hapjes së llogarisë së përdoruesit rezulton, se në rubrikën “Mesazhe” të subjektit në fjalë nuk pasqyrohen njoftimet e fituesit për datat 27.06.2025 e në vazhdim, të cilat janë të dukshme në SPE, në postin e procedurës.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, të publikuar në Buletinin nr.33, datë 30.06.2025 të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është formular standard i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit, përcaktohet: *“Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*

III.1.6. Sa më sipër, bazuar në përcaktimet sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon, se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nis nga dita e marrjes dijeni nga operatorët ekonomikë mbi njoftimin e fituesit dhe përfundon ditën e dhjetë. Komisioni thekson, se për sa kohë që BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, nuk ka marrë dijeni nëpërmjet SPE mbi njoftimin e fituesit, si dhe për sa kohë që në formularin standard të njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr. 33, datë 30.06.2025 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është përcaktuar se me publikimin e këtij njoftimi fillojnë afatet e ankimit, atëherë përlllogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të nisë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë sipas nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar nis që nga data 30.06.2025, dhe përfundon në ditën e dhjetë.

Sa më sipër, ankesa e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar, e për rrjedhojë Komisioni vendosi të shqyrtojë në themel këtë ankesë.

III.2 Lidhur me pretendimin e BOE ankkimues për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “[...] Referuar arsyes se skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke na skualifikuar ne si shoqeri në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se çfare dokumentacioni ne nuk kemi paraqitur per mbeshtetesin sepse ne ditën e percaktuar nga AK ne kemi dorezuar te gjithë dokumentacion ligjore, teknik, ekonomik dhe profesional sikurse e kerkon ligji duke dorezuar edhe fletën e inventarit e cila mban nr. 425/23 prot, date 13.06.2025 pra AK, nr. ky protokolli i vendosur nga vete AK qe verteton marrjen ne dorezim te dokumentacionit tone per kete procedure, po ju citojme se kemi dorezuar te gjithë dokumentacionin e kerkuar dhe ne vecanti ne kundërshtim me ato qe citon AK kemi dorezuar bashkalidhur ketij proceverbali edhe dokumentat per operatorin mbeshtetes “MURATI” sh.p.k: ? Certificate_Regjistrimi (date leshimi 08/01/2025 nr. SN-396015-02-16) ? Ekstrakt_QKB_i Thjeshte tregtar (date leshimi 22/01/2025 nr. J66702413V2025012212065028 2006) ? Ekstrakt_QKB_Historik (date leshimi 22/01/2025 nr. J66702413V2025012212045529 3006) ? VERTETIM Për Statusin Aktiv (date leshimi 08/01/2025 nr. T12166199) ? VERTETIM DETYRIMESH (date leshimi 26/02/2025 nr. T12623482) ? VERTETIM PAGIM KONTRIBUTESH (date leshimi 24/04/2025 nr. T13085954) ? VERTETIM XHIRO E 3 VITEVE_2021 deri 2023 (date leshimi 08/04/2024 nr. T10302870) ? VERTETIM TAKSAT VENDORE 23 deri 24 (13 faqe) ? VERTETIM DEBIE OSHEE me_Mars (date leshimi 05/05/2025 nr. VD000014068) ? BILANCET dhe Audit v21 v22 v23_Te konfirmuara (86 faqe) ? Vertetim Mosperjashtimi_MURATI (date leshimi 07/05/2025 nr. 603d36d091eb4914ba31c320de2c83bf2025050714201320017) ? Vertetim Permbarimi_MURATI (date leshimi 06/05/2025 nr. 131) ? Certificate Gjendje Gjyqësore Penaliteti_MURATI (date leshimi 06/05/2025 nr. 40) ? Vertetim Permbarimi_Eugent MURATI (date leshimi 07/05/2025 nr. 1568) ? Vertetim Permbarimi_Imer MURATI (date leshimi

07/05/2025 nr. 1570) ? Certificate Gjendje Gjyqësore_Eugent MURATI (date leshimi 07/05/2025 nr. 15222) ? Certificate Gjendje Gjyqësore_Imer MURATI (date leshimi 06/05/2025 nr. 11) ? EKSTRAKT I REGJISTRIT TË PRONARIT PËRFITUES (date leshimi 08/01/2025 nr. J66702413V20250108120339860006) ? Vertetime Gjykate Rrethi Diber (date leshimi 03/04/2025 nr. 380) ? Vertetim Prokurorie Rrethi Diber (date leshimi 04/04/2025 nr. -) ? Etj etj Dokumentacion te cilin po jua bashkalidhim edhe ankeses, cka eshte i vertetueshem pasi datat e secilit dokument verteton qe ne e kemi dorezuar pasi mban daten para dates se hapjes se ofertave. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë jone si e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojmë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterit konkret, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, se cilin nga keto dokumenta nuk paskemi dorezuar sipas germave te nenit 26 Formulari Permbledhes i Vetdeklarimit, pra AK ka detyrim qe te mirëargumentoje edhe mosplotësimin e tyre. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, se cfare ne konkretisht nuk plotesojme apo nuk paskemi dorezuar. Per ne si OE kjo shkelje cenon në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenon edhe parimin e sigurisë juridike. Parim i cili në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Edhe ne hipotezen e autoritetit kontraktor qe ne nuk i paskemi dorezuar keto dokumenta cka nuk eshte e vertet, ligjvenesi ne pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 8, tek “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.2.2 Ndërsa, në shtojcën 8, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

III.2.3. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---

E-mail:	----- -----
---------	----------------

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e	Po [] Jo []

mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
--	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

- **Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.**
- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK, të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK. Konkretisht, tek operatori ekonomik “Murati” SHPK, për kapacitete teknike kontrata/eksperienca të ngjashme, duke specifikuar konkretisht kapacitetin: *“Blerje mallrash/materialesh për bashkinë Polican Kontrata prot., 912, datë 18.04.2024, Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Bulqizë Kontrata prot 5484/8, datë 05.12.2022, Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Fier Kontrata prot., 272, datë 04.05.2022, Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Bulqizë Kontrata prot 2151/6, datë 20.06.2023, Blerje mallrash/materialesh për Ndërmarrja e shërbimeve Fier Kontrata prot. 2/15, datë 6.4.2022, Blerje mallrash/materialesh për Ndërmarrja e shërbimeve komunale Durrës Kontrata prot., 808, datë 25.11.2022, Blerje mallrash/materialesh për SHRUKD Kontrata prot., 505, datë 08.06.2023, Blerje mallrash/materialesh për UK Mallakastër kontrata prot., 357, datë 28.10.2022, Blerje mallrash/materialesh për tubo Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier kontrata Kontrata prot., 5/21, datë 15.06.2022, Blerje mallrash/materialesh për Ujësjiellës Kanalizime Roskovec kontrata prot., 221, datë 23.12.2020)*
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Kegli-Duri” SHPK, të firmosur dhe vulosur
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Murati ” SHPK, të firmosur dhe vulosur
- Deklaratë angazhimi e operatorit ekonomik “Murati” SHPK me përmbajtje si vijon: *“[...] ne vihem në dispozicion të angazhimit tonë me përvojat tona të mëparshme në rast të shpalljes fitues të subjektit “Viante Konstruksion” shpk në procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje inerte’, numri i referencës së procedurës REF-36522-01-31-2025, fond limit 161,080,000 lekë pa tvsh, me autoritet kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Konform kërkesave të dokumenteve*

standarte të tenderit dhe legjislacionit në fuqi të sipërpërmendur shoqëria Murati shpk do ta mbështesë “Vianate Konstruksion” shpk duke vënë në dispozicion kapacitetet teknike, si më poshtë: Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Mirditë Kontrata prot. 1552/6, datë 9.11.2020, Blerje mallrash/materialesh për bashkinë Polican Kontrata prot., 912, datë 18.04.2024, Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Bulqizë Kontrata prot 5484/8, datë 05.12.2022, Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Fier Kontrata prot., 272, datë 04.05.2022, Blerje mallrash/materialesh për Bashkinë Bulqizë Kontrata prot 2151/6, datë 20.06.2023, Blerje mallrash/materialesh për Ndërmarrja e shërbimeve Fier Kontrata prot. 2/15, datë 6.4.2022, Blerje mallrash/materialesh për Ndërmarrja e shërbimeve komunale Durrës Kontrata prot., 808, datë 25.11.2022, Blerje mallrash/materialesh për SHRUKD Kontrata prot., 505, datë 08.06.2023, Blerje mallrash/materialesh për UK Mallakastër kontrata prot., 357, datë 28.10.2022, Blerje mallrash/materialesh për tubo Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier kontrata Kontrata prot., 5/21, datë 15.06.2022, Blerje mallrash/materialesh për Ujësjellës Kanalizime Roskovec kontrata prot., 221, datë 23.12.2020).

III.2.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.6. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë

shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.7. “Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.2.8. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operatorë ekonomik konkretisht parashikohet se: "1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti

kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se, “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”, si dhe “Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij”.

III.2.10 Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK, konkretisht, tek operatori ekonomik “Murati” SHPK, si dhe ka dorëzuar në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Kegli-Duri” SHPK, të firmosur dhe vulosur, Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Murati” SHPK, të firmosur dhe vulosur, si dhe Deklaratë angazhimi e operatorit ekonomik “Murati” SHPK. Duke qenë se BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor ndër të tjera dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të mësipërm dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 3999/1 prot., datë 29.08.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën

me nr. 1836/9 prot., datë 17.09.2025, bashkë me dokumente të tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim të cilat si fillim përmbushen përmes deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE ankimues me arsyetimin se: “OE *"M U R A T I"* shpk me Nr NUIS J66702413V ka paraqitur 3 Formular të veçantë të Vetëdeklarimit, por nuk ka paraqitur ne autoritet sipas kërkesës se KVOsë dokumentacion provues ne përmbushje me vetdeklarimin e paraqitur ne Formularin e ngarkuar ne SPE, konkretisht për pikat si me poshtë vijon: • Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_____ nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. • Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi. • Operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; • Operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; • Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. • Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. • Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.”, nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues pranë autoritetit kontraktor, dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së me shkresën me nr. 3999/1 prot., datë 29.08.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, Komisioni konstaton, se BOE “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Kegli- Duri” SHPK , për operatorin ekonomik “Murati” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, nuk ka paraqitur dokumentacionin provues i parashkuar në shkronjat “b”, “c”, “dh”, “e”, “f”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar që provon deklarimet e bëra për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme për kualifikim.

KPP, nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues, si dhe nga administrimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ gjykon se, në pikën 1 dhe 4 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për

prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 4. **Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.**” Referuar pikës 4 të nenit 84 të LPP-së, përcaktohet, se autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërtetohet se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. Në rastin konkret rezulton se, autoriteti kontraktor ka konstatuar mangësi fizike të dokumentacionit të dorëzuar për subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet BOE ankimues. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me arsyen e mësipërme të skualifikimit të këtyre kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 4 të nenit 84 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit. Për këtë arsye, për sa kohë, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, me qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH,

zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

